

14/03/2025

Sot pasdite, në kishat orthodhokse kryhet shërbesa e Himnit Akathist (hymn drejtuar Hyjlindëses Mari), Qëndrimi i dytë.



Në katedralen “Ngjallja e Krishtit”, në Tiranë, do të kryhet në orën 18:00. Himnet karakteristike të kësaj shërbese janë: “Gëzohu, o Nuse e Panusëruar” dhe “Alilua”.

Gjatë pesë javëve të para të Kreshmës, të premtëve në mbrëmje këndohet Himni Akathist.

Në katër të premtet e para, që sivjet bien në datat dt. 7, 14, 21 dhe 28 mars 2025 do të këndohet nga një Qëndrim (stancë).

Ndërsa të premtën e fundit, sivjet në dt. 4 prill do të këndohet i gjithë Himni Akathist, pra të katra Qëndrimet (stancat) së bashku.

Bashkangjitur gjeni tekstin e Himnit Akathist:

<https://orthodoxalbania.org/2020/2020/05/20/himni-akathist/>

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)